

B

ULETIN



TURGUT OZAL
EDUCATION
COMPANY

SHKOLLA E MESME JOPUBLIKE TURGUT OZAL TIRANË



- Competitions
- Activities
- Counseling

REVISTË VJETORE

ISSUE 2 September, 2019

Editor**Jason Simmons****Rajmonda Haxhiaj****Photographer****Oltjan Senja****Designer****Orland Novaku****General assistance****Suela Tasha****Artela Roshi****+355 69 31 83 041****drejtoria@turgutozal.edu.al****Turgut Ozal High School Tirana****Turgut Ozal High School Tirana****Turgut Ozal High School Tirana**

CONTENTS

4	ACADEMIC COORDINATION
5	Olympiads, projects and competitions
6	Graphs
7	3 Minute Science Short Movie Contest
8	Asef
9	Cogito
10	Essay Contest
12	Kangaroo
13	State Olympiad
14	Egmo
15	Mediterranean Youth Mathematical Championship
16	Owlypia
17	Science experiment
18	World Scholar's Cup
19	Testimonial
20	ENRICHMENT
21	Head of Enrichment
22	School Clubs
23	Graphs
24	Debate Club

25	Visit from the US Embassy office
26	Hydropower Plant in Vau i Dejës
27	Eco Club
28	Book Club
29	Book Fair
30	“Donate a Book” Campaign
31	Media and Photography Club
32	Education Through Culture
33	Awareness and Values Club
34	Science Club
35	Sports Club
36	Shpresa Club
37	“Perspective” Youth Center
38	Cooperation
39	School Activities
47	Testimonial
48	SCHOOL COUNSELING AND GUIDANCE
49	Head of School Counseling & Guidance
51	Counseling Seminars
52	Graphs
53	Cooperation with CATS Colleges
54	Different seminars
58	Meeting with the representatives of different Universities
59	Testimonial
60	Students admitted to International Universities

Academic Coordination


Olympiads, Projects & Competitions






GRAPHS


Medals Won at the Owlypia Intellectuals		
Gold	Silver	Bronze
15	16	7




Medals Won at the Owlypia Intellectuals		
Gold	Silver	Bronze
15	16	7




Kogito Olympiad		
Gold	Silver	Bronze
6	5	13




	Gold	Silver	Bronze
Biology	2	2	
Chemistry		4	2
total	2	6	2




3 minutes science short movie content		
Gold	Silver	Bronze
4	10	7



Medals won at Asef		
Gold	Silver	Bronze
3	14	19



Medals Won at National Olympiad					
Math	Physic	Biology	Ict	Literature	Geography
4	3	1	1	2	1



3 Minute Science Short Movie Content



Gjatë muajit shkurt nxënësit tanë morën pjesë në konkursin “3 Minute Science Short Movie Content”. Në këtë konkurs nxënësit morën pjesë në lëndë të ndryshme si: Kimi, Informatikë, Matematikë, Biologji dhe Fizikë, ku prezantuan idetë e tyre në 3 minuta. Si në çdo konkurs nxënësit tanë nderuan shkollën dhe mësuesit duke fituar 4 medalje floriri, 10 medalje argjendi dhe 7 medalje bronzi.

Medaljet e marra nga nxënësit e Turgut Ozal Tiranë në 3 Minute Science Short Movie 2019			
Kimi		Fizikë & Informatikë	
Bronz	DENADA SHAHINI AJLIN HAXHIALUSHI SINDY HUTA & SINDI BEJO	Bronz	BLEDIAN IMERAJ & MARIN QIRIO ERVIN HIMA
Argjend	HEIDI DURRESI & ARTELA ROSHI SILVIA IASHARI & RUDINA KERRI	Argjend	ESTI DAUTAJ & MEGISA MUCA GREISI PEPA & XHOARDA KHIXHO MELISA VADENJA
Flori	MIREK KAZAZI & NOAH MATO ERALDI NELA	Flori	MATIAS MERKO & RILIND HARIZAJ
Matematikë		Biologji	
Argjend	HENRI OLLDASHI	Flori	JOANA JAUPI



TURGUT OZAL HIGH SCHOOL, TIRANA
TURGUT OZAL HIGH SCHOOL, TIRANA



During February, our students participated in the 3 Minute Science Short Movie competition. In this competition our students participated in various subjects such as Chemistry, Informatics, Mathematics, Biology and Physics where they presented their ideas in 3 minutes. Our students honored the school and teachers by winning 4 gold medals, 10 silver medals and 7 bronze medals.

Asef

Konkursi Shqiptar i Shkencës dhe Inxhinierisë është një konkurs që zhvillohet që prej vitit 2008 në kolegjet “Turgut Ozal”. Asef-i është një nga konkurset shkencore më të mëdha në të gjithë vendin, në të cilin nxënësve u mundësohet të shpalosin aftësitë dhe kreativitetin në lëndët shkencore (fizikë, kimi, biologji), TIK, shkenca sociale, linguistikë dhe Web- design, ku ata gjejnë veten dhe japin maksimumin e tyre. Në këtë konkurs u spikatën shumë projekte ku nxënësit u vlerësuan me 3 medalje ari, 14 medalje argjendi, dhe 19 medalje bronxi.



The Albanian Science and Engineering Competition is held since 2008 at “Turgut Ozal” colleges. Asef is one of the largest science competitions in the country, where students are able to show their skills and creativity in physics, chemistry, biology, ICT, social science, linguistics and Web design, where they find themselves and make the most of it. The competition featured many projects where our students were awarded with 3 gold, 14 silver, and 19 bronze medals.



Cogito është një olimpiadë shkencore, e cila zhvillohet midis nxënësve që janë pjesë e kolegjeve. Nxënësit të cilët marrin pjesë konkurojnë në lëndët: Matematikë, Fizikë, Kimi, Biologji, TIK dhe Anglisht. Synimi i kësaj olimpiade është që të ndihmojë nxënësit dhe t'i përgatisë ata për olimpiadat kombëare dhe ndërkombëtare.

Falë angazhimit të nxënësve dhe mësuesve në olimpiadën e 8 të Cogito-s u fituan 23 medalje si më poshtë:

MEDALJE ARI

Gea Ivanaj (Fizikë), Mired Kazazi (Biologji), Eraldi Nela (Kimi), Fiona Ramilli (anglisht), Gledis Kondi (Anglisht), Albi Ceci (TIK).

MEDALJE ARGJENDI

Loren Llagami (Fizikë), Henri Oldashi (Biologji), Rilind Haziraj (Anglisht), Melisa Vadenja (Anglisht), Kevin Cuni (TIK).

MEDALJE BRONZI

Rajsa Shega (Fizikë), Klevis Mecaj (Fizikë), Pamela Mera (Biologji), Andi Babasi (Biologji), Rafaelo Hoxha (Biologji), Breana Shehatilla (Biologji), Ana Radoniqi (Kimi), Elion Selko (Kimi), Enrik Sina (Kimi), Ramazan Tafa (Anglisht), Marin Shpata (Anglisht), Erisa Shehu (Anglisht), Rubin Aga (Anglisht).



Cogito is a scientific Olympiad, which takes place among the students who are part of Turgut Ozal colleges. The students participate in such subjects as Mathematics, Physics, Chemistry, Biology, ICT and English. The aim of this competition is to help students prepare for national and international Olympiads. Thanks to the commitment of our students and teachers to the 8th Cogito Olympiad, 23 medals were won.

Essay competition

Në rrugëtimin e tyre drejt shkencës nxënësit e kolegjit “Turgut Özal” morën pjesë në një konkurs eseje në kuadër të ditës botërore të ADN-së, më 25.04.2019. Konkursi i esesë është një konkurs i zhvilluar në rang vendi dhe Europe. Ky konkurs u zhvillua midis gjimnazistëve të Tiranës nga të cilët dhe shkolla jonë pati disa përfaqësues. Nga 78 pjesëmarrës në konkurs, nxënësjja jonë Pamela Mera fitoi çmimin e parë në rang vendi. Eseja fituese përfaqësoi Shqipërinë në konkursin e zhvilluar në Suedi gjatë muajit Qershor. Në këtë konkurs nxënësit tanë treguan se kanë aftësi për shkencën dhe zhvillimin e detyrave me metoda shkencore.



On their journey to science, students of our school participated in an essay competition in the framework of the World Day of DNA on 25.04.2019. The essay competition is developed nationwide and in Europe. It was developed among students of high schools in Tirana where our school had several representatives. Out of 78 participants in the competition, our student Pamela Mera won the country's first prize. The winning essay represented Albania in the competition held in Sweden during June. In this competition our students showed that they have skills for science and they are able to develop tasks with scientific methods.



Era Kasmí

Nxënësja më e mirë e shpallur në konkursin e esesë, zhvilluar nga Universiteti Bedër, ku morën pjesë 32 shkolla dhe 147 ese.

Era Kasmí.

The Best Student Announced in the Essay Contest, organized by Beder University, attended by 32 schools and 147 essays.



Kangaroo

Kanguri është një konkurs i përvitshëm që zhvillohet në lëndën e matematikës dhe ka si qëllim të njohë nxënësit dhe mësuesit me probleme dhe ushtrime të programit shkollor në një mënyrë të këndshme, tërheqëse dhe pa ndier ankthin e konkurimit. Ky konkurs iu vjen në ndihmë dhe mësuesve, për të njohur nivelin e nxënësve që konkuruan. Deri më sot janë të paktën 90 shtete në botë që zhvillojnë këtë konkurs në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme. Ndër to konkuruan edhe 450 nxënës të shkollës sonë duke dhënë më të mirën e tyre.

Nxënësit tanë provuan aftësitë e tyre matematikore në disiplinat gjeometri, algjebër, teori numrash etj. Disa prej tyre arritën të dilnin fitues nga ky kompeticion.

Patrick Kola

Erik Kaçani

Livia Bezati

Evi Tafaj



Kangaroo is an annual competition that is developed in the subject of mathematics and aims to familiarize students and teachers with problems and exercises of the curriculum in a pleasant, attractive way and without feeling the anxiety of the competition. This competition helps also the teachers recognize the level of students who compete. Until now, there are at least 90 countries in the world that run this contest in the 9-year grade and high schools. Among them also 450 students of our school competed by doing their best.

Our students were tested for their math skills in geometry, algebra, numeracy, etc.

Among the winners we can mention:

Patrick Kola

Erik Kaçani

Livia Bezati

Evi Tafaj

OLIMPIADA SHTETERORE

Gjatë vitit shkollor 2018-2019 nxënësit e shkollës së mesme jopublike “Turgut Özal” Tiranë zhvillojnë Olimpiadën shtetërore në lëndët: Biologji, Kimi, Fizikë, Gjeografi, Informatikë, Matematikë dhe Letërsi . Si çdo vit radhazi, edhe këtë vit, shkolla jonë u paraqit me pjesëmarrës në të gjitha lëndët. Arritjet e shkollës në olimpiada kanë qenë gjithmonë të kënaqshëm. Në këto olimpiada pati më shumë se 100 pjesëmarrës dhe shumë fitues.

Fitues në olimpia kombëtare 2018-2019

Matematikë:

Heidi Durrësi, Bruno Bajo, Marin Qirjo, Dejvi Barçi

Fizikë:

Bruno Bajo, Oresti Bano, Albi Ceci

Biologji:

Heidi Durrësi

Informatikë:

Albi Ceci

Letërsi:

Artela Rroshi, Jera Isakaj

Gjeografi:

Henri Olldashi



During the 2018-2019 school year, the students of the non-public high school Turgut Ozal Tirana develop the State Olympiad in the subjects: Biology, Chemistry, Physics, Geography, Informatics, Mathematics and Literature. As every year in a row this year our school was presented with participants in all subjects. School achievements in the State Olympiads have always been pleasing. In the state Olympiad there were more than 100 participants and many winners.

Winners in the state Olympiad 2018-2019

Mathematics:

Heidi Durrësi, Bruno Bajo, Marin Qirjo, Dejvi Barçi

Physics:

Bruno Bajo, Oresti Bano, Albi Ceci

Biology:

Heidi Durrësi

ICT:

Albi Ceci

Literature:

Artela Rroshi, Jera Isakaj

Geography:

Henri Olldashi



Heidi Durrësi, nxënëse e shkollës “Turgut Ozal”, përfaqësoi Shqipërinë në Olimpiadën VIII Europiane të Matematikës për vajza, që u mbajt këtë vit në Ukrainë, duke fituar një medalje nderi.

Falenderojmë mesuesit e përkushtuar, të cilët me anë të punës së palodhur kanë ndihmuar në trajnimin e nxënësve të olimpiadës. Shpresojmë që kjo arritje të jetë shkas për suksese të mëtejshme.



Heidi Durresi, a student of Turgut Ozal School, represented Albania at the VIII European Girl Mathematics Olympiad held this year in Ukraine, she won a medal of honor.

A special thank goes for the dedicated teachers that through their hard work trained and helper our students of the Olympics. We hope that this achievement will lead to further success.

Konkursi Mesdhetar i Matematikës për të Rinj

Konkursi Mesdhetar i Matematikës për të Rinj, MYMC 2019, i cili u zhvillua në Napoli, Itali, në datat 17-20 korrik, i solli një tjetër fitore shkollës sonë. Ek-
ipi shqiptar i të rinjve përbëhej nga katër nxënës për-
faqësues të shkollave të mesme “Turgut Ozal” Tiranë
dhe “Turgut Ozal” Durrës: Bruno Bajo, Heidi Durrë-
si, Loard Bejko dhe Dea Myshketa.

Në sajë të punës së vazhdueshme dhe mbështetjes
profesionale, ky grup arriti të fitojë Medaljen e Bronz-
it në këtë konkurs të rëndësishëm ndërkombëtar.

Kjo fitore e dyfishtë na bën të jemi krenarë!
Suksese të mëtejshme!

The MYMC 2019 Mediterranean Youth Mathemat-
ics Competition, which took place in Naples, Ita-
ly, on July 17-20, brought another victory to our
school. The Albanian youth team consisted of four
students representing “Turgut Ozal” high schools
in Tirana and “Turgut Ozal” Durrës: Bruno Bajo,
Heidi Durrës, Loard Bejko and Dea Myshketa.

Thanks to their hard work and professional sup-
port, this group managed to win the Bronze Med-
al in this important international competition.

This double win makes us proud!
Further successes!



Owlypia

Owlypia është një konkurs ndërkombëtar për nxënësit e moshave 11-14 (Owlets) dhe 15-18 vjeç (Owlys), në të cilin nxënësit mund të marrin pjesë në pesë fusha të ndryshme si: Social studies, Art & Design, Literature & Culture, Science & Technology, Economics & Business.

Si në çdo konkurs tjetër, edhe këtë here nxënësit tanë e përfaqësuan denjësisht shkollën tonë duke shpalosur njohuritë e tyre në këto fusha dhe duke vënë në punë kreativitetin e tyre.

Nxënësit tanë konkuruan me 31 shtete ku nderuan Shqipërinë me 15 medalje ari, 16 medalje argjendi dhe 7 medalje bronzi.



"Owlypia The Intellectual's Challenge"
Cambridge University, England 17-20 June 2019

 ERIK KOCANI 4 Gold medals 1 Silver medal	 ARTELA ROSHI 2 Gold medals 2 Silver medals	 ADISA MEHMETI 2 Silver medals 1 Bronze medal	 MEGAN DURAJ 3 Gold medals 1 Bronze medal	 EDA ZUSI 1 Silver medal 2 Bronze medals	 HENRI OLLASHI 3 Gold medals 1 Silver medal
 MARK SHKRIJA 2 Gold medals 2 Silver medals	 LINA BEZATIT 1 Gold medal 2 Silver medals	 AIDA HASANI 2 Silver medals 2 Bronze medals	 JERA ISAKAJ 2 Silver medals 1 Bronze medal		

TURGUT OZAL HIGH SCHOOL TIRANA
f
TURGUT OZAL HIGH SCHOOL TIRANA

Owlypia, is an international contest for students aged 11-14 (Owlets) and 15-18 (Owlys), where students can participate in five different areas: Social Studies, Art & Design, Literature & Culture, Science & Technology, Economics & Business. Same as other competitions, our students have duly represented our school by expanding their knowledge in these areas and putting their creativity into practice. Our students competed with 31 countries honoring Albania with 15 gold medals, 16 silver medals and 7 bronze medals.



Science Experiment

Science experiment është një konkurs shkencor midis klasave të 10-ta të të gjitha kolegjeve në lëndët: Biologji, Kimi dhe Fizikë. Në këtë konkurs shkolla jonë u përfaqësua me shumë projekte nga nxënës në të gjitha lëndët. Me shpirtin e tyre sfidues, nxënësit tanë arritën të rrëmbejnë në lëndën e biologjisë 2 medalje ari me eksperimente rreth përcaktimit të grupit të gjakut, 2 medalje argjendi me eksperimente rreth veprimit enzimatik në frutin e ananasit dhe dy medalje bronxi në eksperimente rreth identifikimit të ADN-së nga gjurmët e gishtave nëpërmjet një aparati të krijuar nga vetë ata. Gjithashtu, nxënësit rrëmbyen medalje dhe në lëndën e Kimisë, ku u morën 4 medalje argjendi dhe 2 medalje bronxi.



Science Experiment is a scientific competition between the 10th grades of all colleges in Biology, Chemistry and Physics. In this contest our school was represented with many projects by students in all subjects. With their challenging spirit, our students managed to achieve 2 gold medals in Biology with experiments like blood group test, 2 silver medals with experiments like enzymatic action on pineapple fruit, and 2 bronze medals in the experiment to identify DNA from fingerprints through a device created by themselves. The students also achieved 4 silver medals and 2 bronze medals in Chemistry.



World Scholar's Cup

Në kompeticionin ndërkombëtar “World Scholar's Cup”, të mbajtur në Sarajevë, Bosnje më 1-2 Prill, morën pjesë 24 shkolla nga 3 shtete me rreth 300 nxënës, 9 nga të cilët, nxënës të shkollës së mesme “Turgut Ozal”, Tiranë. Këta nxënës u ndanë në 3 grupe dhe arritën të fitojnë 56 medalje nga kategoritë e shumta, siç ishin “Team Challenge”, “Scholar's bowl”, “Debate” etj.



The international competition “World Scholar's Cup”, held in Sarajevo, Bosnia, on April 1-2, was attended by 24 schools from 3 countries with about 300 students, 9 of whom were students of Turgut Ozal High School, Tirana. These students were divided into 3 groups and managed to win 56 medals from multiple categories, such as Team Challenge, Scholar's Bowl, Debate and others.



Bruno Bajo

Testimonial

Mathematics is a passion which has always accompanied me during my academic education. The desire to know more and to reveal new secrets of math has attracted me since the childhood. However, sometimes in life, opportunities that are given to us are the ones which determine how far we can develop our abilities. I feel myself privileged that these opportunities were offered to me by “Turgut Ozal Tiranë” college. They definitely lightened my perspective towards learning especially in Mathematical Olympiad. There were certain facets which headed me towards success in mathematical competition, but among them I would prefer to mention the qualifying work of my teachers. What I really appreciate is that the teachers are always there if you are eager to learn more. Their readiness to help is an example of great work. Each of my teacher has put his or her own piece to the mosaic of my academic education. Among them I would like to thank with deep gratitude professors: Ozgur Kirçak and Erisa Muhja. They taught me the desire to work on math and that it is important to enjoy the beauty of it. Professor Ozgur Kirçak noticed my abilities and supported me confidently. He showed patience and discipline while supervising me on my way. During the weekends the college organized camps for math olympiad. In those camps, I met Professor Ozgur Kirçak who really presented to me a different method of thinking to come up with the solution to a problem. I would progress quite a lot after each weekend. To sum up, these opportunities, resulted in great achievements such as receiving first prize in National Mathematical Olympiad and the second prize in National Physics Olympiad, participating in a prestigious International Olympiad as Balkan Mathematical Olympiad, and recently receiving the bronze medal in Mediterranean Youth Mathematical Olympiad. I will always be thankful to “Turgut Ozal Tiranë” college and I will never forget every single contribution that they gave to me.

Matematika është pasioni i cili më ka shoqëruar gjithmonë gjatë rrugëtimit tim akademik. Dëshira për të ditur më shumë dhe për të zbuluar sekrete të reja të matematikës më ka tërhequr që në fëmijëri. Sidoqoftë, ndonjëherë në jetë, mundësitë që na jepen janë ato që përcaktojnë se sa mund t'i zhvillojmë aftësitë tona. Ndihej i privilegjuar që këto mundësi më janë ofruar nga kolegji “Turgut Ozal Tiranë” i cili ndikoi në këndvështrimin tim drejt të mësuarit, veçanërisht në Olimpiadën Matematikore. Kishte disa faktorë që më drejtuan drejt suksesit në konkurset matematikore, por midis tyre do të preferoja të përmend punën e kualifikuar të mësuesve të mi. Ajo që vlerësoj më të vërtetë është se mësuesit kanë qenë gjithmonë aty për ne, nëse kishim ambicie për të mësuar më shumë. Gatishmëria e tyre për të ndihmuar është një shembull i një pune të shkëlqyer. Duket sikur secili nga mësuesit e mi ka vendosur copëzën e tij ose të saj në mozaikun e arsimit tim akademik. Midis tyre dëshiroj të falënderoj me një mirënjohje të veçantë profesorët: Ozgur Kirçak dhe Erisa Muhja. Ata më mësuan dëshirën për të punuar në matematikë dhe çka është më e rëndësishme për të shijuar bukurinë e saj. Profesori Ozgur Kirçak vuri re aftësitë e mia dhe më mbështeti vazhdimisht. Ai tregoi durim dhe disiplinë ndërsa më mbikëqyrte gjatë rrugëtimit tim. Gjatë fundjavave kolegji organizonte kampe për olimpiadën e matematikës. Në ato kampe, unë u njoha me profesorin Ozgur Kirçak i cili me të vërtetë më mësoi një metodë të veçantë të menduarit për të arritur zgjidhjen e një problemi. Pas çdo fundjave unë e kuptoja që po përmirësohesha. Në një panoramë të përgjithshme, këto mundësi që m'u ofruan, rezultuan në arritje të spikatura midis të cilave mund të përmend: marrjen e çmimit të parë në Olimpiadën Kombëtare Matematike dhe çmimin e dytë në Olimpiadën Kombëtare të Fizikës, pjesëmarrjen në një Olimpiadë prestigjioze Ndërkombëtare si Olimpiada Matematike Ballkanike, dhe së fundmi marrjen e medaljes së bronzit në Olimpiadën Matematike të Rinjve të Mesdheut. Do të jem gjithnjë mirënjohës për kolegjin “Turgut Ozal Tiranë” dhe nuk do ta harroj kurrë çdo kontribut që dha për mua.



Enrichment



Brikela Salihaj

Head of Enrichment

Zyra “Head of Enrichment” në gjimnazin “Turgut Özal” ka shërbyer për pasurimin me aktivitete të vitit akademik. Detyra e kësaj zyre të veçantë të shkollës sonë është informimi i nxënësve rreth aktiviteteve të ndryshme që shkolla ndërmerr gjatë vitit shkollor, si dhe organizimi i këtyre aktiviteteve në bashkëpunim me nxënësit. Ky bashkëpunim ka qenë eficient në strukturimin e aktiviteteve në shkollën tonë, arsye kjo e cila na shtyn ta kthejmë zyrën në pjesë integrale të strukturave të shkollës.


The “Head of Enrichment Office” in our school has served to further enrich the academic year with activities. Its duty is to inform our students about the activities the school organizes, while also being responsible for organizing said activities based on the different requests of the students. This cooperation between school and student has proven itself efficient enough to become an integral part of the school administration.

**School
Clubs**

GRAPHS

School Clubs

Charity club	Media and photo club	Awareness and values club	Science club	Book club	Debate club	Sport club	Ecology club
100	37	30	15	16	34	25	15



KLUBI I DEBATIT (Debate Club)

-Ndëthurrja e Cogito Ergo Sum me jetën shkollore dhe aktualitetin-

Klubi i Deabit në gjimnazin “Turgut Özal” ka si qëllim kultivimin e mendimit kritik në mënyrën se si anëtarët e klubit argumentojnë. Me anë të diskutimeve rreth temave të forta sociale, anëtarët e klubit janë shtyrë të mësojnë se si formohet një argument, si strukturohet ai, si mbrohet, dhe sigurisht, edhe se si fitohet një debat. E veçanta e këtij klubi shkollor është mundësia e tij unike për të krijuar ballafaqim të opinioneve, gjë që inkurajon shprehjen e mendimit jashtë kornizës dogmatike, që karakterizon opinionin publik shqiptar. Përpos debateve të përjavshme, klubi organizon dhe bashkëbisedime me personalitete të fushave të ndryshme të jetës shoqërore rreth temave më shqetësuese të realitetit shqiptar si është edhe liria e medias dhe e shtypit. Gjithashtu, duke marrë shkas nga temat e debateve (të cilat janë zgjedhur kryesisht nga vetë anëtarët), klubi organizon dhe vizita në institucione të ndryshme për të mundësuar njohjen nga afër të procedurave që institucionet (qofshin ato private apo publike), zgjedhin për të realizuar qëllimin e operimit të tyre. Duke patur mundësinë unike të njohjes me faktin përmes syve të tyre dhe pa filtra, anëtarët e klubit janë të prirur të formojnë opinione të pandikuara nga filtrat e ndryshëm me të cilët individë apo autoritete të ndryshme të realitetit shqiptar, mundohen të veshin faktin dhe të vërtetën.

Për këto arsye ftojmë çdo nxënës të gjimnazit tonë të bëhet pjesë e Klubit të Debatit, me bindjen se kjo ka për të qenë ndër eksperiencat më të vlefshme në jetën e tyre shkollore.



- Cogito Ergo Sum's crawling with school life and current -

The Deabit Club at Gymnasium “Turgut Ozal High School” aims to cultivate critical thinking in how club members argue. By discussing strong social topics, club members are moved to learn how to form an argument, how it is structured, how it is protected, and of course, how to win a debate. The specialty of this school club is its unique opportunity to create a confrontation of opinions, which encourages the expression of thought outside the dogmatic framework characterizing the Albanian public opinion.

In addition to weekly debates, the club organizes conversations with personalities of different areas of social life about the most disturbing topics of Albanian reality such as media and press freedom. Also, having taken up the subject of debates (which are mainly elected by the members themselves), the club organizes visits to various institutions to enable close observation of the procedures that institutions (whether private or public) choose to realize the purpose of their operation. Having the unique ability to get acquainted with the fact through their eyes and without filters, club members are inclined to form uninformed opinions from the different filters with which individuals or different authorities of Albanian reality try to wear the fact and the truth.

For these reasons, we invite each student of our gymnasium to become part of the Debate Club, with the conviction that this will be among the most valuable experiences in their school life.

Vizitë nga zyra e Ambasadës Amerikane (Visit from the US Embassy office)

Shefi i Zyrës së marrëdhënieve me publikun pranë Ambasadës Amerikane, Z. **Brian Beckmann** në bazë të programit Folësi i Ambasadës vizitoi nxënësit e shkollës sonë. Prezantimi pati një interes shumë të lartë dhe interaktivitet ndërmjet nxënësve dhe Z. Beckmann. Ai u foli mbi punën e tij në zyrën e shtypit të Ambasadës dhe shpalosi këndvështrimin e tij mbi median në Shqipëri.



The Head of Public Relations Office at the US Embassy, Mr. Brian Beckmann, on the basis of the Embassy Speaker program, visited the students of our school. The presentation had a very high interest and interactivity between students and Mr Beckmann. He talked about his work at the Embassy's press office and shared his outlook on the media in Albania.

Hidrocentrali në Vaun e Dejës (Hydropower Plant in Vau i Dejës)

Në të njëjtën frymë të mësimit praktik kundrejt atij metodik, Klubi i Debatit, duke marrë shkas nga një debat konstruktiv mbi prodhimin dhe konsumin e energjisë elektrike në Shqipëri, zhvilloi një vizitë në hidrocentralin e Vaut të Dejës. Kjo vizitë u dha mundësinë anëtarëve të klubit që të njihen me të gjithë procesin e prodhimit të energjisë elektrike nga afër, si dhe të mund të formojnë argumente të forta të pandikuara nga asnjë filtër qoftë ai mediatik, politik apo dhe i një grupi të interesi.

Bindja se përballja e drejtpërdrejtë, pa asnjë medium ndërmjetësues në përçimin e informacionit, kombinuar me metodën karteziante të mendimit kritik dhe dyshues janë mënyra më potente për formimin e mendimit autentik dhe të pavarur të individit është dhe arsyeja se përse shkolla jonë është plotësisht e angazhuar në mundësimin e këtyre vizitave edukuese.



In the spirit of practical and methodical learning, the Debate Club, due to a constructive debate on electricity production and consumption in Albania, paid a visit to the Vau i Dejes hydropower plant. This visit enabled the members of the club to get acquainted with the entire electricity production process closely and to form solid arguments without any filter, whether it is media, political or a group of interests.

They left convinced that direct confrontation, without any mediating media in the transmission of information, combined with the Cartesian approach to critical thinking and suspicion, are the most powerful way to form an authentic and independent thought.

KLUBI I EKOLOGJISË (Eco Club)

Klubi i Ekologjisë (ECO Club), është themeluar ne vitin 2017 nga një grup nxënësish dhe mësuesish të shkollës “Turgut Ozal”. Qëllimi kryesor i klubit është sensibilizimi dhe informimi i nxënësëve mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit, ruajtjes dhe trashëgimisë së resurseve natyrore, si dhe promovimin e një jetese të shëndetshme.

Në kuadër të këtyre qëllimeve klubi ka ndërmarrë një sërë aktiviteteve si për shembull: zbukurimi i ambienteve të shkollës me vazo lulesh të përshtatura nga materiale të ricikluara; projekti “Ju Mund! 3” në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës, mbledhja e baterive të përdorura, pjesëmarrja në konkursin shkencor ASEF me projektin ekologjik dhe ekonomik, një ngrohese e ndërtuar me ane të materialeve të ricikluara e cila përdore energjinë e marrë nga dielli etj.

Në besojmë se angazhime të tilla na ndihmojnë të kultivojmë dashurinë për natyrën dhe jetesën e mirë si dhe zgjojnë ndërgjegjen qytetare.




The ECO Club was founded in 2017 by a group of students and teachers of the Turgut Ozal School. The main purpose of the club is to raise awareness and inform students about the importance of environmental protection, conservation and heritage of natural resources, as well as promoting a healthy lifestyle.

Within these goals the club has undertaken a number of activities such as: decorating school grounds with flower pots adapted from recycled materials; the project “You Can! 3” in collaboration with the Municipality of Tirana, collection of used batteries, participation in the ASEF scientific competition with the ecological and economic project, a recycled material heater that uses solar energy etc.

We believe that such engagements help us cultivate a love of nature and good living and awaken civic consciousness.

KLUBI I LIBRIT (Book Club)

E kush më mirë mund të flasë për librin sesa ata që e prekin dhe marrin njohuri të ndryshme çdo ditë prej tij, nxënësit. Janë ata që janë në krye të çdo aktiviteti që zhvillohet nga Klubi i Librit. Një ndër këto aktivitete ishte studimi i bërë më temën Vlera e librit. Pikënisja ishte me ndërtimin e anketave, shpërndarjen e tyre në klasa dhe përpunimin e të dhënave. Nga studimi u nxorën statistika që iu pasqyruan nxënësve të shkollës sonë. Gjatë prezantimit të seminarit u arrit qëllimi i këtij klubi, pra ndërgjegjësimi i nxënësve për vlerat e rëndësishme të librit.



Who better to study the value of books than the Book Club Students. These students conducted a study on the value of books by creating a survey, distributing them into classes, and processing the data. The results of the survey were shared during a seminar presented by the Book Club reflecting what the students wanted from the Book Club, their awareness of book values, and how important they are.

Anëtarët e klubeve të Medias dhe të Librit vizitojnë Panairi i 21-të i librit (Book Fair)



Fushata “Dhuro një libër” (Campaign “Donate a Book”)



Edukimi nuk është vetëm çështje e institucioneve arsimore, por është mbi të gjitha detyrim njerëzor. Nisur nga ky koncept që shkolla jonë ka mbi arsimin, këtë vit është ndërmarrë dhe fushata “Dhuro një libër” që nxit nxënësit të shkëmbejnë librat dhe bashkë me ta dhe dijen që ata përmbajnë. Përgjigjja pozitive e trupit tonë studentor u reflektua në numrin prej 270 libra të mbledhur.



Contributions to education is not only the job of educational institutions, but it is students as well. In accordance with this philosophy, Turgut Ozal has created “Donate a Book” campaign, which encourages students to share books, and thus, the knowledge they contain.

KLUBI I MEDIAS DHE FOTOGRAFISË (Media and Photography Club)

Gjatë vitit akademik 2018-2019, ndër klubet më aktive ka qenë ai i Medias dhe Fotografisë. Workshop-et në studion fotografike “Kumi” dhe nga qendra rinore “Perspektiva”, vizitat në Ekspozitën e Tiranës dhe Muzeun “Marubi”, në bashkëpunim me Klubin e Debatit një bisedë me gazetarin Marin Mema dhe biseda me drejtorin e medias në Ambasadën Amerikane, Brian Beckman rreth temës “Freedom of Speech and Democracy in Albania”, fitorja me dy vendet e para në ekspozitën e organizuar nga të rinjtë e gjimnazeve të Tiranës, TWTOExpo, ku Blerti Cungu dhe Era Milo, respektivisht fitues të vendeve të parë dhe të dytë të ekspozitës, kanë qenë dhe “fotografët” më të pëlqyer në rrjetin social Instagram, kanë qenë vetëm disa nga aktivitetet e shumta të klubit. Përveç aktiviteteve të lidhura me median dhe fotografinë, ky klub ka qenë i angazhuar dhe në edukimin e ndjenjës qytetare. Një aktivitet në Azilin e Pleqve, vizitë në Panairin e Librit, seminar mbi të drejtën e autorit me folëse Sonila Mekën, një video e realizuar për sigurinë në Internet (në bashkëpunim me projektin e Komisionit Europian, “Safer Internet Day”), kanë shërbyer si mjete edukimi të përgjegjësive qytetare. Megjithatë, angazhimi i këtij klubi nuk përfundon vetëm te ushqimi i ndjenjës humanitare apo përballjes me realitetin e profesioneve të gazetarit dhe fotografit, por dhe në ushtrimin e dyshimit kartezian e forcimin e ndërgjegjes kombëtare. Për këto arsye ky klub si dhe Klubi i Librit, kanë marrë pjesë në projektin kombëtar “Mbresa: kujtojmë për të mos harruar”, në Muzeun Kombëtar të Sigurimit të Shtetit, “Shtëpia me gjethe”, ku janë njohur me krimet dhe tmerret e komunizmit më gjerësisht se sa njihen në librat e shkollës, për fat të keq. Anëtarësia në këtë klub do të përbënte vlerë të shtuar për çdo nxënës të gjimnazit të interesuar ose jo në media apo fotografi.



During the 2018-2019 academical year, the Media and Photography club has been among the most active. Workshops at “Kumi” photo studio and youth center “Perspektiva”, visits at the “Tirana Exhibition” and “Marubi” Museum, the talk with journalist Marin Mema and the media director of the US Embassy, Brian Beckman (in conjunction with the Debate Club), winning the first two places of the youth-organised photo exposition “TWTOExpo”, where Blerti Cungu and Era Milo, respectively first and second place winners, were the most liked “photographers” on Instagram, were only some of the club’s various activities. In addition to media and photography, this club has been thoroughly engaged in educating a feeling of civil responsibility. Visits to the Elderly Nursing Home, The Book Fair, a seminary with Sonila Meka regarding Copyright Infringement, filming a video for the EU Comission Project “Safer Internet Day”, have all served in educating proper citizens. To educate our students with the Cartesian Doubt, together with the Book Club, we have participated in the national project “Mbresa” and visited the “House of Leaves” Museum, where members have been presented with the horrible crimes of comunism. Membership in this club is a valuable experience for every student, interested in media and photography or not.

Edukimi përmes kulturës (Education through culture)

Shtëpia e gjetheve

Tmerr,nga krimet e komunizmit...Neveri, për fantazinë e çmendur nxitur nga dëshira për të shkatërruar jetë njerëzish...Frikë, për brishtësinë e lirisë...diktaturat nuk janë asnjëherë aq larg sa ne mendojmë,...Revoltë,sepse askush ende nuk ka kërkuar falje... Përgjigjen,pse ekzistojnë njerëz që akoma e përmendin diktaturën si ar-ritje,sepse asnjë nga vrasësit e kombit nuk është dënuar ende dhe Dyshimin, që gjithë ato jetë dhe sakrifica u tretën si kripa në një det me lotë...

Këto ishin ndjenjat që shoqëruan vizitën e nxënësve tanë në Muzeun Kombëtar të Sigurimit të Shtetit. Kjo vizitë, organizuar nga Klubi i Medias dhe Fotografisë dhe Klubi i Librit, si përgjigje ndaj programit edukues "Mbresa", vjen si një prirje pozitive për njohjen e së kaluarës historike nëpërmjet kontaktit të drejtpërdrejtë me faktin. Megjithatë në kushtet në të cilat historia dhe ndërgjegjja jonë kombëtare ndodhen sot, përpos edukimit praktik që iu mundësua anëtarëve të këtyre grupeve, do të ishte i nevojshëm dhe imediat dhe një edukim teorik, i plotë dhe i unifikuar për çdo nxënës të Republikës së Shqipërisë, sepse vetëm njohja e plotë e historisë së përgjakshme të atij regjimi mund të shmangë ripërsëritjen e tij.



House of leaves

Horror, of the the communist crimes ... driven by the desire to destroy the lives of people ... Afraid of the fragility of freedom ... dictatorships are never as far as we think ... Revolt, because no one has yet apologized ... The answer why there are people still mentioning dictatorship as an accomplishment because none of the nation's assassins have been condemned yet and the doubt that all of those lives and sacrifices were abolished as salt in a sea of tears...

These were the feelings that accompanied the visit of our students to the National Security Museum. This visit, organized by the Media and Photography Club and the Book Club, in response to the "Mbresa" educational program comes as a positive trend for recognizing the historical past through direct contact with the fact. However, in the conditions in which our national history and consciousness are today, apart from the practical education provided to members of these groups, it would be necessary and immeasurable and a theoretical, complete and unified education for every student of the Republic of Albania, because only full knowledge of the bloody history of that regime can avoid replicating it.

KLUBI I NDËRGJEGJËSIMIT DHE VLERAVE (Awareness and Values Club)

Ndërgjegjësimi dhe vlerat janë elementët thelbësor të njeriut. Një ndër klubet e rëndësishme të shkollës “Turgut Özal” është edhe Klubi i Ndërgjegjësimit dhe Vlerave i cili diskuton dhe realizon me nxënësit tema dhe projekte të ndryshme sociale. Një ndër angazhimet kryesore të klubit ka qënë lufta ndaj fenomenit të bullizmit, projekt i cili u realizua me sukses dhe u prezantua nëpër klasa. Inicjatori kryesor i projektit ishin nxënësit Arbi Mazhaku dhe Kjara Manja. Me mbështetjen e Zyrës së Këshillimit dhe Udhëzimit, klubi prezantoi një temë mbi çrregullimet e të ngrënit (temë e përgatitur nga nxënësjja Zerina Kopliku) në shkollën 9-vjecare “Turgut Özal”, aty ku krijohen komplekset e para ndaj imazhit për veten.

Aktiviteti i ndërmarrë nga vetë nxënësit ishte seminari i përgatitur nga nxënësjja Artela Roshi mbi “Organizimi dhe Menaxhimin e Kohës”, një prezantim interaktiv i nxënëses më bashkëmoshatarët e saj.

Klubi pati vizita dhe nga të jashtëm, nga ku duhet përmendur seminari mbi Life Coaching nga Coach RN Dr. Dana Lombardi, një seminar shumë motivues për nxënësit tanë. Një ecure edhe më të sukseshme është qëllimi i klubit për vitet në vazhdim.



Awareness and values are the essential elements of man. One of the important clubs of the Turgut Ozal High School is the Awareness and Values Club, which discusses various social topics and projects. One of the club's main commitments has been to the phenomenon of bullying. The project was successfully implemented and introduced into classes. The main initiator of the project was student Arbi Mazhaku and Kjara Manja. In support of the Counseling and Guidance Office, the club managed to introduce one of its themes in the 9-year-old Turgut Ozal School, a theme on eating disorders prepared by pupil Zerina Kopliku, considering that there is an age group that begins creating image complexes for themselves.

The seminar prepared by the student Artela Roshi on "Organizing and Managing Time", an interactive interview of the student with her peers, was presented.

The club had visits from outside, such as the Life Coaching Seminar on Coaching RNDr by Dana Lombardi, which was a very motivational seminar for our students. An even more successful performance is the club's goal for the coming years

KLUBI I SHKENCËS (Science Club)

Klubi i Shkencës ka arritur të bëjë shumë aktivitete që kanë qënë shumë interesante dhe ndihmuese për nxënësit. Rugëtimin e aktiviteteve e nisi në muajn dhjetor dhe në vazhdimësi. Pjesa më e madhe e aktiviteteve u sugjeruan nga nxënësit dhe u realizuan po nga ata me mbukqyrjen e mësuesve. Ndër më të interesantet që mund të përmëndim nga aktivitetet janë vizitat në Muzeun e Shkencave të Natyrës , në Fakultetin e Shkencave të Natyrës si dhe zhvillimin e eksperimenteve të ndëryshme : ekstraktimi i AND, osmoza te patatja, veprimi i peroksidit te hidrogjenit ne kataladën e mëlcise dhe patates. Gjatë vizites ne F.Sh.N nxënësit vizituan ambientet e laboratorëve të shtazorëve vertebrior dhe invertebrior ku u njohën nga afër me skeletë shpendësh, reptilësh, amfibësh dhe gjitarësh. Gjithashtu nxënësve iu mundësua një seancë deseksioni i një bretkose, i një sepjeje dhe një peshku, nga ku nxënësit vëzhguan në mënyrë të drejtpërdrejtë anatominë e tyre.



The Science Club has engaged in many activities that have been very interesting and helpful to the students. The activities started in December and continued through the year. Most of the activities were overseen by the students and they were carried out by the teachers. Among the most important educational activities were to the Faculty of Natural Sciences and the development of interdisciplinary experiments such as DNA Extraction, Potato Osmosis, and Action of Hydrogen Peroxide in the Catalan Liver and potato. During the visit to the F.Sh.N students visited the premises of the vertebrate and invertebral animal laboratories where they were closely acquainted with skeletons of birds, reptiles, amphibians and mammals. Also, students were given lesson on the frog, a cuttlefish and a fish, in which students directly observed their anatomy.



KLUBI I SPORTIT (Sports Club)

Kampionati i futbollit

Gjatë muajve nentor – dhjetor u zhvillua kampionati i futbollit midis klasave të 10-ta, 11-ta dhe të 12-ta. Kjo periudhë kohore pati angazhim maksimal nga nxënësit e klubit duke dhënë më të mirën e tyre në sportin e preferuar të futbollit.

Kampionati i voleybollit

Kampionat tjetër ishte ai i voleybollit për djemtë i zhvilluar në muajin prill ndërmjet klasave të 11-ta dhe 12-ta, nga ku kupën e fitoi klasa e 11-B.

Edhe vajzat tona nuk duhen lënë pa përmendur përsa u përket lojrave sportive, ato shkëlqyen në kampionatin e voleybollit që zhvilluan ndërmjet tyre. Kampioni u shpall klasa e 12-G.

Ndeshjet nuk u kufizuan vetëm brenda shkollës sonë, duke qenë se, vajzat e klasave të 10-ta zhvilluan një ndeshje miqësore me nxënëse të klasave të 9-ta të shkollës “Adrian Klosi”.



Football championship

During November-December, the Football Championship took place between the 10th 11th and 12th grades. During this period of time the students displayed their maximum commitment and effort for their favorite sport.

Volleyball Championship

The next championship was the volleyball match for the boys held in April between the 10th, 11th and 12th grades, from which the cup was won by the 11th class.

Even our daughters should not be left unnoticed in terms of sports games; they fell into the volleyball game that took place between them. The grade 12 G was the champion.

The matches were not limited to the school, but also included the competition with the school Adrian Klosi. The friendly match took place between the 10th grade of the Turgut Ozal High School and 9th grade at the school Adrian Klosi.



KLUBI SHPRESA (Shpresa Club)

Solidariteti në shkollën tonë është një ndër pikat më të rëndësishme dhe më humane. Klubi Shpresa është një klub që në fillimet e tij ka pasur si synim t'ju vijë në ndihmë çdo kauze ku ndihet nevoja. Puna e nxënësve dhe idetë e tyre ndihmuan sado pak individë në vështirësi. Aktivitetet më të rëndësishme që duhen përmendur për këtë klub, të organizuar nga nxënësit dhe mësuesit përkatës janë: vizitat dhe dhënia e ndihmave në Qendrën Sociale Multidisiplinare, ndihma në familjet në nevojë, vizitë dhe ndihmë materiale në Institucionin e Nxënësve që nuk Dëgjojnë. Nuk duhen lënë pa përmendur edhe vizitat dhe ndihma në Shtëpinë e të moshuarve dhe në shkollën speciale “Luigj Gurakuqi”.



Solidarity in our school is one of the most important and humanitarian points. From its beginning, The Charity Club, was intended to help in whatever capacity is necessary. Students came up with their ideas to help individuals in need, and then work to implement them. The most important activities to be mentioned for this club, organized by the students and their respective contributors, are the visits and assistance provided at the Multidisciplinary Social Center, Helping Families in Need and Visiting and Assisting the Institution of Non-Listening Institutions.

Qendra rinore “Perspektiva” (“Perspective” Youth Center)

Qendra rinore “Presperktiva” dhe shkolla e mesme “Turgut Özal” në një bashkëpunim tepër frytdhënës sollën një mënyrë inovatore për t’i thënë JO shprehjes së diskriminimit ndaj njëri-tjetrit.

Kreativiteti ishte fjala kryesore e Work Shop-it të organizuar.

Nxënësit u nxitën të krijonin mesazhe domethënëse nëpërmjet artit, muzikës, fotografisë, videove ,grafik design-it etj, duke rritur ndërgjegjësimin tek ta për të ngritur krye kundër bullizmit, por gjithashtu edhe dukurive të tjera negative me të cilat ndeshet shoqëria shqiptare sot.



The Youth Center Perspective and the high school "Turgut Ozal" in a very fruitful collaboration, brought an innovative way of saying NO to the act of discrimination against one another.

Creativity was the key word of the Organized Work Shop.

The students were encouraged to create meaningful messages via art, music, photography, video, graphic design etc, that helped raise awareness at ways to combat bullying and other problems that Albanian society faces today.

Shkolla Mike

Turgut Ozal këtë vit shkollor pati bashkëpunim me shkollën speciale “Luigj Gurakuqi”. Ishte Klubi Shpresa që ka inicjuar këtë bashkëpunim. Nga vizita që u bë në këtë shkollë nga nxënësit tanë pati një mikpritje të ngrohtë nga ana e tyre. Nxënësit tanë dërguan disa dhurata për këta fëmijë, në mënyrë që dita e tyre të mbushej me lojra të ndryshme. Shkolla “Luigj Gurakuqi” kishte përgatitur një seminar duke na njohur me historikun e saj dhe se si janë shtuar nxënësit në këtë institucion që të përmirësojnë vështiresitë e tyre. Nxënësit panë nga afër ambiente të shkollës, pajisjet që ndihmonin në trajtim të këtyre nxënësve me vështirësi specifike si dhe bashkëpunuan në mënyrë interaktive me ta në palestrën e këtij institucioni.



This year Turgut Ozal cooperated with the special school "Luigj Gurakuqi", thanks to the wishes at the Club the students were warmly welcomed at the school, and they enjoyed giving gifts to the other students. The Luigj Gurakuqi School conducted a seminar by familiarizing us with its history and that the students were added to this institution to improve their difficulties. The students visited the environment and the school, the equipment that helped these students with specific difficulties and interacted with them at this school.



AKTIVITETET SHKOLLORE (School activities)

Zgjedhjet në shkollën tonë

Këtë vit shkollor në shkollën tonë u mbajtën zgjedhjet për presidentin e shkollës dhe senatorët e klasave. Nxënësi-president, i cili zgjidhet nga votat e nxënësve të tjerë, përfaqëson zërin e tyre në shkollë. Zgjedhjet u organizuan në shkollë nga vetë nxënësit me ndihmë të stafit dhe secili kandidat bëri fushatën e tij.



Elections in our school

The school had elections for the school president and class senators. The student president, who is elected by the vote of the other students represents their voice at the school. Elections were organized at school by the students themselves with the help of staff, and each candidate run their campaign.



Java e filozofisë

Me nxënësit e klasave të 11-ta, që këtë vit kanë në kurrikul dhe filozofinë, është zhvilluar dhe Java e Filozofisë. Gjatë kohëzgjatjes së këtij aktiviteti, në korridoret dhe hollet e shkollës janë vendosur dhe afishuar me dhjetëra punime të nxënësve tanë. Bukuria e këtij aktiviteti dhe sharmi i shtuar, vijnë nga variateti i rrymave të mendimit të shprehura dhe te mundësia e krijuar si për mbështetjen e rrymave filozofike, aq dhe për kritikën ndaj tyre. Vlera edukative e kësaj jave të veçantë e tejkalon “target group-in” e klasave të 11-ta dhe është bindja jonë që çdo nxënës i shkollës ka mësuar të paktën një pjesëz së një doktrine filozofike dhe me shpresë kjo pjesëz do të rezultojë në një studim shumë shumë më të thellë të nënës së shkencave.



Week of philosophy

The students of the 11th grade have arranged and prepared the Philosophy Week. During this activity, the halls of the school have been set up to display dozens by works of our students. The beauty of this activity charms come from the variation of thoughts expressed, and the opportunity created for both the expression of philosophical ideas and the criticism of them. The educational value of this particular week exceeds the "target group" of the 11th grade, and it is our conviction that every school student has taught at least one part of a philosophical doctrine, and hopefully, this work will result in deeper study of the mother of sciences.



Java e historisë

“Çdokush që nuk e njeh mirë historinë është i destinuar ta ripërsërisë atë.”
-Bërke

“Historia është një rrëfenjë e treguar nga pala që ka arritur të sundojë.”
-Dan Brown

Janë dy shprehjet që e portretizojnë më mirë marrëdhënien e popullit shqiptar me historinë e tij të dhimbshme. Për këtë arsye, gjimnazi “Turgut Özal”, ka zhvilluar Javën e Historisë. Sado që ky aktivitet ka një prirje pozitive për mësimin e historisë dhe shmangien e përsëritjes së saj, nxënësit tanë janë gjithsesi pjesë e realitetit shqiptar. Një realitet me histori të falsifikuar që vazhdon ende të shkruhet nga pala që arriti të sundojë. Ky aktivitet, më shumë se një shtysë për mësimin e historisë nga nxënësit, shërben dhe duhet të shërbejë për sintetizimin e kërkesës së një historie xhenuine, të pakaluar në filtrat e pushtetit të djeshëm. Duhet të jetë kujtesë për rishkrimin e historisë bazuar në fakt dhe jo në propagandë. Duhet të jetë shtysë si për nxënësin dhe prindërit e tij. Ky aktivitet, më shumë se çdo aktivitet tjetër, i tejkalon muret e shkollës-ato konkrete, por dhe abstrakte. Me shpresën se kjo nxitje për mësimin e historisë do të jetë faktor që çdo nxënës i shkollës sonë do të kërkojë të vërtetën dhe datat historike të kombit të tij dhe jo të festojë qorrazi përvjetoret e datave historike jugosllave apo të ngulmojë te faktet e fabrikua



Week of history

“Anyone who does not know the story well is destined to reshape it.”
Berk

“History is a story told by the party that has managed to rule.”
-Dan Brown

Two expressions that better portray the relationship of the Albanian people with its painful story. For this reason, Turgut Ozal High School has prepared the History Week. Although this activity has a positive impact towards for learning history and avoiding its repetition, our students are, however, part of the Albanian reality. A reality with a fake story that continued to be written by the party that came to rule. This activity, more than one impetus for learning history from students, serves and should serve to synthesize the demand for a hijab history, lacking in yesterday's power filters. It should be a tool for rewriting history based on fact and not propaganda. There must be impetus for both the student and his parents. This activity, more than any other activity, surpasses the walls of the school - both concrete and abstract ones. It is the hope that this incentive for history teaching will be a factor that any student of our school will seek the truth and historical dates of his/her nation and not celebrate the anniversaries of Yugoslav historical dates or insist on fabricated facts.

Java e letërsisë

Krahas aktiviteteve spontane dhe mbështetëse të kurrikulës, në shkollën tonë janë zhvilluar dhe zhvillohen aktivitete të përvitshme si Java e Letërsisë. Ky aktivitet i muajit tetor është veçanërisht i veçantë dhe i rëndësishëm si dhe aktiviteti i parë i vitit akademik. Kategoritë e konkurrimit përfshijnë:

- Konkursin e Esesë
- Konkursin e Vizatimit
- Konkursin e Këngës
- Konkursin e Recitimit

Ky lloj konkursi ka për qëllim stimulimin e autenticitetit të shprehjes dhe kreativitetit. Temat e përzgjedhura mjeshhtërisht nga stafi ynë pedagogjik, gërshtuar me trupin e talentuar studentor, ia dalin të nxisin gjithmonë krijime mahnitëse dhe mbresëlënëse, e për rrjedhojë dhe shumë medalje në finalet mes shkollave.



Week of literature



In addition to the spontaneous and supporting activities of the curriculum, our school has developed annual activities such as the Literature Week. This October activity is particularly special and important and is the first activity of the academic year. The competition categories include:

- Essay contest
- Drawing contest
- Song Contest
- Recitation Contest

This kind of contest is intended to stimulate of expression and creativity. The topics carefully selected by our pedagogical staff, intertwined with the talented student body, can always come up with impressive creations, and consequently produce many medals in the finals among the schools.

Eskursionet

Nxënësit e klasës së 11-të shijuan bukurinë e natyrës dimërore në një nga vendet më të bukura turistike të rajonit, në Mavrov.

Nëntori mbërriti bashkë me ngjyrat e vjeshtës. Për t'u bërë pjesë e natyrës dhe për të shijuar momente të bukura pranë saj, nxënësit e klasave të 12-ta vizituan bregdetin e Durrësit dhe malin e Dajtit. Ku ka më bukur se të prekësh qiellin dhe të jesh pranë detit në një ditë vjeshtore!

Nxënësit e klasave të 11-ta patën mundësitë që dijen e tyre në histori dhe gjeografi ta përmirësonin dhe më shumë nga vizita në bregdetin e Adriatikut dhe në kalanë e Elbasanit.

Ndërsa klasat e 10-ta ishin për shëtitje në qytetin historik të Beratit.

Një udhëtim tepër i veçantë u zhvillua me nxënëset e klasave të 10-ta për të shijuar turizmin dimëror në një nga vendet më të njohura të Maqedonisë, në pistën e skive, parkun kombëtar dhe liqenin "Mavrova". Nuk i mungoi këtij udhëtimi as turizmi kulturor, shijimi i natyrës e monumenteve të saj në qytete si Struga e Ohri.

Shëtitje në Kolashin

Fundjava ishte ndryshe për nxënëset e klasave të 12-ta. Me destinacion qytetin e Kolashinit, ata, së bashku me mësueset e tyre bënë një udhëtim tepër tërheqës në Mal të Zi, duke shëtitur e vizituar vende të veçanta. Gjithçka ishte tepër e bukur, sidomos vajtja në pistën e skive, shëtitja me teleferik në malin Bjelasica dhe e gjithë kjo e shoqëruar nga pamjet e mahnitshme të parkut ndërkombëtar i mbuluar i gjithi me borë!



Excursions



The students of the 11th grade enjoyed the beauty of winter nature in one of the most beautiful tourist places in the region, Mavrov.

November arrived along with autumn colors. To become part of nature and to enjoy beautiful moments near it, 12th grade students visited the coast of Durres and Mount Dajti, where it is better to touch the skies and be near the sea on a Fall day.

The students of the 11th grade could expand their knowledge of history and geography, during their visit to the coastal shore of the Adriatic and Elbasan, while the 10th grade students visited the historic city of Berat.

A special trip took place with 10th grade students to enjoy winter tourism in one of the most popular places in Macedonia, the ski run, the national park and the lake, Mavrova. There was no lack of cultural tourism, or taste of nature and its monuments in cities such as Struga and Ohrid.

Visiting Kolasin

The weekend was different for 12th grade students. With the destination of Kolasin city, they together with their teachers made a very attractive trip to Montenegro by visiting special places. Everything was beautiful, especially skiing on the ski run, the cable car ride on Mount Bjelasica and all this accompanied by amazing views of the international park covered with snow!

Vizitë në institucionin e parlamentit

Gjimnazi “Turgut Özal” është plotësisht i angazhuar në mirëedukimin e nxënësve si qytetarë model. Për ta zhvilluar sa më mirë ndjenjën e qytetarizmit, një individ duhet të jetë koshient për institucionet shtetërore dhe funksionin dhe rolin e tyre në strukturimin e jetës shoqërore në komunitet. Kjo bindje e thellë që lidhet ngushtësisht me metodikën tonë të arsimimit ka qenë edhe arsyeja se pse klasa 11-A ka zhvilluar këtë vit një vizitë në Kuvendin e Shqipërisë, kur mundësia u krijua dhe pse për fat të trishtë kjo mundësi konvergoi me një situatë të agravuar në marrëdhënien politikë-arsim. Gjithsesi, turi në godinën e parlamentit dhe më pas dëgjimi i një pjese të seancës i njohu nxënësit nga afër me procedurat dhe funksionimin e parlamentit dhe vetëm kur një individ është i mirëinformuar, ai mund të mbajë një qëndrim të matur në çdo situatë.



Visit to the institution of parliament

Turgut Ozal High School is fully committed to educating students as model citizens. To better develop the sense of citizenship, an individual should be mindful of state institutions and their role in structuring social life in the community. This deep conviction that is closely related to our methodology of education is why class 11A visited the Assembly of Albania when the opportunity was created. Fortunately, this opportunity converged with a corrupt situation in the political-education relationship. However, mourning in the parliament building and then listening to a part of the hearing briefly acquainted the students with the procedures and functioning of the parliament, and only when an individual is well-informed he can maintain a measured attitude in any situation.



Summer School

Një grup nxënësish të klasës së 10-të ndoqën një shkollë verore 2 javore në Londër. Ata gjithashtu morën certifikata pas mbarimit me sukses të këtij aktiviteti.



A group of our 10th grade students had a 2 week summer school in London. They have achieved their certificate after finishing the summer school with success.



Mbrëmja e maturës

Në jetën e njeriut, diplomimi në shkollën e mesme nuk është thjesht një “gur kilometrik”, por edhe një etapë e rëndësishme në udhën e së ardhmes.

Sot koha juaj erdhi!

Urime për secilin prej jush për këtë arritje të madhe të diplomimit nga shkolla e mesme jo-publike ‘Turgut Ozal’. Gjatë këtyre viteve ju keni punuar shumë dhe tani jeni gati dhe të përgatitur për të kaluar në botën e universitetit dhe të punës. Ne jemi shumë krenarë për arritjet tuaja në shkollën tonë.

Ju urojmë suksese dhe bekime të vazhdueshme gjatë ditëve dhe javëve tuaja të mbetura si studentë të shkollës sonë dhe qofshi të lumtur, të arrirë dhe të sigurtë kudo që t’ju shkelë këmba.

E ardhmja është e vështirë, por dijet që keni fituar në këtë shkollë do t’ua lehtësojnë rrugëtimin akademik dhe profesional.

Kjo shkollë është e nderuar që pati mundësinë të kontribuonte sadopak në këtë etapë të rëndësishme të jetës suaj.

Suksese dhe mbarësi për të gjithë ju!





Marin Shpata Testimonial

In order that a society reaches its maximum rate of democracy and stability, education is undoubtedly essential. The contemporary world has complex needs which require new solutions, often times far away from the traditional. Thus, education, as the only medium which's able to shape the new man, has been subjected to multiple crucial changes to reach its optimal state. At Turgut Ozal High School, in addition to academical excellence, through different activities and competitions, we are developing a set of skills that are rather important for an universal preparation. This year was filled with plenty of activities. For the students who fancy science ASEF (Albanian Science & Engineering's Fair) and Cogito Olympiad were the perfect choice. In these competitions we found the opportunity to combine creativity with our great passion for science. Other students, talented in arts, took part in activities organized during "Literature's Month". Personally I've been the most active in the Debate's Club. After the tiring school periods, I could hardly wait for the group to gather around the table at the meetings' room and discuss about the day's topic. Time passed and we didn't even notice, it seemed as if we never debated enough. Being active in this club improved our confidence, speaking skills and helped us succeed in international competitions such as Worlds' Scholars' Cup and Owlypia at Cambridge University, where I was awarded the "Best Debater" prize. Alongside multiple different clubs, we've had the opportunity to take part in several seminars and educational programs. We had a very good time with "No Hate Speech" movement as well, an Erasmus+ program supported by the European Union. All participating students, mainly by using talents of the artistic spectrum, took a stand and tried to raise awareness on hateful behaviors. This way we as students discover qualities of ourselves which we hadn't known before, we progress and enhance our knowledge. In the same time each and every one of us understands that the unknown isn't frightening, in fact it's quite the opposite it's the engine which powers human curiosity. During this whole process we interact; understand that our individual needs differ, consequently tolerance comes in handy as a solution in most instances. This entire experience cultivates open mindedness and prepares us for a unified world.

Në mënyrë që një shoqëri të arrijë shkallën maksimale të demokracisë dhe qëndrueshmërisë, arsimi është padyshim i nevojshëm. Por, nevojat komplekse të botës kontemporane kanë nevojë për zgjidhje të reja, shpesh herë larg tradicionales. Kësisoj, edukimi, si medium i vetëm krijues i njeriut të ri, i është nënshtruar disa ndryshimeve thelbësore për të arritur në gjendjen optimale në të cilën ndodhet sot. Ne, në Gjimnazin Turgut Ozal, krahas ekselencës akademike, nëpërmjet aktiviteteve dhe konkurseve të ndryshme, po zhvillojmë një sërë aftësish shumë të nevojshme për këtë përgatitje universale. Ky vit ka qenë i tejmbushur me aktivitete të shumëllojshme ku secili prej nesh mund të gjente vetveten. Për nxënësit e apasionuar mbas shkencës ASEF-i dhe Olimpiada Cogito ishin zgjedhja perfekte. Tek to, ne mundëm të kombinonim kreativitetin me pasionin tonë të madh për shkencën. Të tjerë nxënës, të talentuar në interpretim, vizatim e shkrim morën pjesë në aktivitetet e zhvilluara në kuadër të Muajit të Letërsisë. Personalisht kam qenë më aktiv në Klubin e Debatit. Pas orëve të lodhshme mësimore mezi prisja të uleshim rreth tavolinës në sallën e mbledhjeve e të debatonim për temën e ditës. Kurrë nuk na dilte koha, gjithnjë dëshironim të shtonim diçka më shumë, e gjenim veten duke debatuar edhe përgjatë korridorit teksa ktheheshim në klasat përkatëse. Ky aktivizim i përherëshëm gjatë vitit shkollor na dha garanci për të hedhur hapa të sigurtë në konkurse ndërkombëtare si World's Scholars' Cup apo edhe Owlypia në Universitetin e Kembrixhit, ku u shpalla debatuesi më i mirë. Krahas klubeve të shumta kemi patur mundësinë të zhvillojmë seminare dhe programe të ndryshme. Një ditë shumë të këndshme e kaluam në shoqërinë e lëvizjes "No Hate Speech", program Erasmus+ i mbështetur nga Bashkimi Europian. Gjithësecili prej nesh, duke përdorur aftësitë tona kryesisht të spektrit artistik, shprehëm qëndrimin tonë duke u munduar në të njëjtën kohë, të ndërgjegjësonim të tjerët mbi fjalët të cilat shpërndanë urrejtje. Ne, nxënësit, në këtë mënyrë, zbulojmë tek vetvetja cili të panjohura më parë dhe si rrjedhojë i përvetësojmë ato, duke u bërë më të ditur. Në të njëjtën kohë, kuptojmë se e panjohura nuk është frikësuese, përkundrazi është motorri i cili vendos në punë kuriozitetin natyral njerëzor. Përgjatë këtij procesi ne të gjithë së bashku ndërveprojmë; kuptojmë se nevojat individuale janë të ndryshme e se toleranca shpesh herë është zgjidhja e mjaft problemeve. Kjo eksperiencë në tërësi na bën më mendjehapur e më të përgatitur për një botë të unifikuar.

School Counseling and Guidance



Bilal Kocagoz

Head of School Counseling and Guidance

Shërbimet e udhëzimit dhe këshillimit në një shkollë është një nga nevojat më të rëndësishme në një institucion arsimor modern dhe të sigurt. Në vitin akademik 2018-2019, shkolla e mesme Turgut Ozal fuqizoi këtë shërbim duke themeluar departamentin e drejtimit dhe këshillimit duke përfshirë një drejtor departamenti, një psikolog, dy këshilltarë të shkollës dhe një këshilltar të arsimit të lartë. Studentët kanë nevojë për udhëzime dhe mbështetje, veçanërisht kur bëhet fjalë për trajtimin e presioneve akademike, personale, prindërore dhe sociale. Këshilltarët tanë të shkollës Z.Mehmet Karateke dhe Znj.Erisa Shehu ndihmojnë studentët në të gjitha nivelet dhe ata mund të lundrojnë problemet me besim nga viti i parë deri në diplomim. Ata veprojnë si avokatë për mirëqenien e studentëve dhe si burime të vlefshme për përparimin e tyre arsimor. Këshilltarët tanë të shkollës dëgjojnë shqetësimet e studentëve. Për shkak se jeta shtëpiake dhe shoqërore e të gjithëve është e ndryshme, një këshilltar shkollor mund të jetë personi i vetëm që plotëson atë nevojë për ta. Psikologu shkollor Miss Suela Tasha ndihmon studentët me çështje të tilla si ngacmimi, aftësi të kufizuara, vetëvlerësimi i ulët, performanca e dobët akademike dhe problemet në marrëdhënie. Këshilltarët e shkollës i referojnë studentët në shërbimin tonë të psikologjisë. Për më tepër, ata vlerësojnë aftësitë, interesat dhe personalitetet e studentëve për t'i ndihmuar ata të zhvillojnë qëllime realiste akademike dhe karriere. Një shërbim tjetër i rëndësishëm në shkollën tonë është këshillimi për arsimin e lartë. Ne organizojmë seminare periodike të karrierës, mundësi universitare, procese aplikimi dhe bursa. Këshilltarja jonë e arsimit të lartë znj.Sonila Shehu ndjek aplikimet universitare të këshillimit të studentëve tanë dhe ajo informon studentët për universitetet në të gjithë botën. Studentët tanë pranohen me bursa nga universitete prestigjioze jashtë vendit. Si shef i departamentit të udhëzimit dhe këshillimit dëshiroj të falënderoj të gjithë anëtarët e departamentit tonë për përpjekjet e tyre dhe t'u uroj suksese të mëtijshme studentëve tanë të dashur.

Guidance and counseling services in a school is one of the most important necessities in a modern and confident educational institution. In 2018-2019 academic year, Turgut Ozal high school empowered this service by establishing guidance and counselling department including a department head, one psychologist, two school counsellors and one higher education counselor. The students need guidance and support, especially when it comes to dealing with academic, personal, parental and social pressures. Our school counsellors Mr.Mehmet Karateke and Mrs.Erisa Shehu assist students at all levels and they can navigate problems with confidence from first year until graduation. They act as advocates for students' well-being, and as valuable resources for their educational advancement. Our school counselors first and foremost listen to students' concerns. Because everyone's home and social life is different, and a school counsellor could be the only person who fulfills that need for them at a given time. The school psychologist Miss Suela Tasha helps the students with issues such as bullying, disabilities, low self-esteem, and poor academic performance and relationship troubles. The school counsellors refer the students to our psychology service. In addition, they evaluate the students' abilities, interests and personalities to help them develop realistic academic and career goals. Another important service in our school is higher education counselling. We organize periodic career seminars, university opportunities, application processes and scholarships. Our higher education counsellor Mrs.Sonila Shehu follows the university applications of our students counselling and she informs the students about universities in all over the world. Our students are accepted with scholarships by prestigious universities in the world. As head of guidance and counselling department I would like to thank all our department members for their efforts and wish further success to our dear students.



Erisa Muhja
School Counselor

Sonila Shehu
Higher Education Counselor



Mehmet Karateke
School Counselor




Suela Tasha
Psychologist




Counseling Seminars

GRAPHS

Students admitted to the universities of these countries.								
USA	UK	Germany	Italy	Austria	Netherland	Canada	Bulgaria	Others
11	5	23	1	4	6	1	1	10



Universities	
Students in Albania	Students acceptance outside Albania
98	62



Bashkëpunimi me Kolegjet CATS (Cooperation with CATS Colleges)

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi, planifikohet që pranimi i nxënësve në kolegjet CATS të fillojë në shtator 2019.

Nxënësit e shkollës sonë do të kenë tashmë mundësinë për të studiuar në kolegjet CATS në Angli, Evropë dhe SHBA.

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Turgut Ozal education sh.a dhe CATS Colleges në Britaninë e Madhe dhe SHBA, përfaqësues të CATS College ishin në shkollën tonë dhe mbajtën një prezantim informues për nxënësit. Shpresojmë që të ketë shkëmbim eksperiencash midis institucioneve në sajë të këtij bashkëpunimi.



Within the framework of this cooperation agreement, it is planned that the acceptance of students in the CATS Colleges will start in September 2019.

Our students will now have the opportunity to study at CATS Colleges in England, Europe and the US.

In the framework of the cooperation agreement between Turgut Ozal Education sh.a and CATS Colleges in Great Britain and USA, representatives of CATS College were in our school and held an informative presentation for the students.

SEMINARE TË NDRYSHME PËR NXËNËSIT (DIFFERENT SEMINARS FOR THE STUDENTS)

Nuk është kurrë heret për të menduar për të ardhmen.

Zyra e Udhëzimit dhe Këshillimit në shkollën tonë organizoi seminarin e radhës me përmbajtje: program orientimi për klasat e 11-ta në degët: Informatikë Biznesi, Ekonomik, Financë Bank, Inxhinieri Kompjuterike, Juridik, Shkenca Politike dhe Mardhënie Kombëtare si dhe Arkitekturë.



It's never too early to think about the future.

The Office of Counseling at our school organized the next seminar with content: orientation program for the 11th grade in Business, Economics, Finance, Computer Engineering, Law, Political Science and National Relations as well as Architecture.

Herda Xhaferaj, ish-nxënëse e “Turgut Ozal”, ndau eksperiencën e saj si një nga studentët më të mira të Universitetit të Harvardit. Takime të tilla motivuese u vijnë në ndihmë nxënësve tanë për t’i orientuar sa më mirë drejt së ardhmes së tyre.

Sheila Durrësi, diplomuar nga Universiteti Yale në bachelor dhe Universiteti Harvard në gradën Master dhe Doktor i Shkencave, ndau eksperiencën e saj si studente e mjekësisë me nxënësit e shkollës “Turgut Ozal”. Sheila shpjegoi gjithashtu edhe hapat që duhet të ndiqen nga studentët për aplikime sa më të suksesshme në universitet botërore.

Ish nxënës në “Turgut Ozal”, **Flori Doçi**, student i Shkencave Kompjuterike në këtë universitet vizitoi shkollën tonë duke qënë bashkeprezantues ne seminarin e realizuar nga universiteti Jacobs. Duke treguar ekseprience e tij, ai dha një ndihmë të vlefshme për nxënësit tanë që ishin në fazën e vendosjes se çfarë do të ndjekin për të ardhmen.



Herda Xhaferaj, a former “Turgut Ozal” student, shared her experience as one of the best students of Harvard University. Such motivational meetings help our students to better guide their future.

Sheila Durrës, graduated from Yale University with a bachelor and Harvard University with a Master’s and Doctor of Science degree and shared her experience as a medical student with Turgut Ozal students. Sheila also explained the steps that should be followed by students for the most successful applications at the world university.

Flori Doci, a Computer Science student at this university and former student of “Turgut Ozal” visited our school as a co-representative at the seminar organized by Jacobs University. Pointing to his appearance, he provided a helping hand to the students who were in the phase of deciding what to pursue for the future.

Seminari me temë: **“Getting ready for a letter of motivation and International Examinations”**, i mbajtur nga **Dr. Isa Erbas**, drejtor i shkollës së mesme “Turgut Ozal” pati si qëllim të përgatisë nxënësit e klasave të njëmbëdhjeta me një vizion të qartë të rrugës që ata duhet të ndjekin për të arritur suksesin. Seminari i informoi nxënësit mbi teknikat e shkrimit të një letre motivimi dhe i njohu ata me provimet më të rëndësishme ndërkombëtare, si SAT, TOEFL dhe IELTS.

Seminar on “Getting Ready for a Letter of Motivation and International Examinations”, held by Dr. Isa Erbas, director of “Turgut Ozal” high school. It was intended to prepare 11th grade students with a clear vision of the way they should follow to achieve success. The seminar informed the students about the techniques of writing a motivation letter and introduced them to the most important international exams, such as SAT, TOEFL and IELTS..



Përfaqësuesja e **“The Intellectual Challenge”** mbajti një seminar ku u bë prezantimi i nxënësve me formatin e konkursit prestigjioz ndërkombëtar “Owlypia” (ku bëjnë pjesë universitete si Harvard dhe Cambridge).

The Owlypia “Intellectual Challenge” representative held a seminar where students would be able to take part in the prestigious international Owlypia competition (featuring universities such as Harvard and Cambridge).



Në shkollën e mesme “Turgut Özal” u zhvillua seminari me temë **“5 ligjet e kujtesës”** nga **Dr. Atakan Derelioglu** me klasat e 10-të.

Dr. Atakan Derelioglu conducted a seminar to the 10th grade students about “5 laws of memory”.





Arkitekti **Genti Grabova**, i diplomuar në universitetin e Arkitekturës në Londër, prezantoi sot për nxënësit e interesuar të klasave 11-ta në Turgut Ozal kërkesat e universitetit për regjistrim, pagesat, mësimdhënien si dhe jetën studentore në Angli.

The Architect Genti Grabova, a graduate of the University of Architecture in London, met the 11th grade students. He gave information to the students about university registration, payment, studying and student life in England.

Mendimi filozofik bashkëkohor karakterizohet nga qasja dyshuese ndaj dogmave, qofshin ato edhe sociale. Në kontrast me vendet e Perëndimit, në të cilat qasja dyshuese dhe mendimi individual kanë arritur të krijojnë realitetin e lirisë, në vendin tonë vënia në dyshim dhe liria e mendimit kanë qenë sakrilegj për 5 dekada të karakterizuara nga mungesa e zhvillimit. Duke qenë se forma më e mirë e edukimit të këtij dyshimi është eseja, në shkollën tonë **Profesor Doktor William Karl Martin**, profesor amerikan me përvojë të gjatë në pedagogji, aktualisht pedagog në universitetin BEDËR, ka zhvilluar dy seminare: njërin për nxënësit me temë **“Si të shkruajmë një ese”** dhe një trajnim me mësuesit për metodat më efikase të mësimdhënies, në mënyrë që dhe nxënësit dhe mësuesit e shkollës sonë të jenë sa më të orientuar ndaj modelit perëndimor të mësimdhënies dhe të shkëputen nga modeli i çimentuar i lindjes.



Contemporary philosophical thinking is characterized by a doubtful approach to dogmas, whether it is social. In contrast to the Western countries where the suspicious approach and individual opinion have managed to create the reality of freedom, in our country the questioning and freedom of thought have been sacrilege for 5 decades characterized by a lack of development. Given that the best form of education of this doubt is the essay, at our school Professor William Karl Martin, a professor with long experience in pedagogy, currently a lecturer at BEDER University, held two seminars: one for students on “How to write an essay” and a teacher training on the most effective teaching methods so that both our students and teachers can be more orientated to the Western model of teaching and disconnected from the cemented birth model.

Takime me përfaqësues të Universiteteve të ndryshme (Meeting with the representatives of different Universities)

Në shkollën tonë patëm fatin të kishim një përfaqësues nga North American University, **Z. Omer Kilinc**, i cili u bë pjesë e një takimi tepër miqësor dhe frytsjellës me nxënësit e klasave të 12-ta, të cilët do të aplikojnë në Universitetet më të mira amerikane.



In our school we were lucky to have a representative from North American University, Mr. Omer Kilinc, who was part of a very friendly and fruitful meeting with 12th grade students who will apply to the best universities in the US.



Z. Peter Tsvetkov nga Univeriteti Jacobs University Bremen zhvilloi një seminar, ku njohu nxënësit me mundësitë e shumta që ky universitet ofron si përsa i përket programeve të ndryshme akademike, po ashtu stafit tepër të kualifikuar dhe mbështetës të profesorëve, lehtësitë e jetesës studentore, si edhe mbështetjen financiare që u jepet studentëve internacionalë, si një mundësi e shkëlqyer për të pasur një të ardhme të sigurt.

Dr. Jeanette Rieger-Cowdry dhe Alba Canit dy përfaqësueseve të zyrës rajonale DAAD Lektorat Albania prezantuan seminarin informues në lidhje me studimin në universitetet gjermane për nxënësit e klasave të 12-ta.



Dr. Jeanette Rieger-Cowdry and Alba Canit, two representatives of the regional office DAAD Lektorat Albania, presented a seminar on the study of German universities for the 12th grade students.

Mr. Peter Tsvetkov, from the Jacobs University in Bremen, held a seminar, where he acquainted students with the many opportunities that the university offers. He discussed the different academic programs, as well as highly qualified and supportive staff of professors, student living facilities, and the financial support given to international students.



Ines Bici

Testimonial

Having a consultancy office at our school really helped me this school year. Besides the warm, friendly and motivating environment it offered information on a lot of opportunities all around the world. The office guided me through each and every step of the applications and made sure that we were on the right path to getting admitted. We worked on recommendation letters, motivation letters, personal essays, resumes, certificates and activities I could be part of in order to enrich my CV. Our school counselor, Mrs. Sonila has been always available for each of us, but most importantly she has motivated and inspired us to make the right choices regarding our future studies, in my case regarding architecture. At the end of it, with her help, I managed to get accepted to a number of universities including UC Berkeley, Michigan University, Northeastern, Worcester Polytechnic Institute etc. I had the opportunity to choose between some of the world's best universities, and now I'm waiting for the fall semester to start.

Të pasurit e një zyre konsulence në shkollën tonë më ndihmoi shumë këtë vit shkollor. Përveç mjedisit të ngrohtë, miqësor dhe motivues, zyra ofroi informacion për shumë mundësi studimi në mbarë botën. Zyra më instrukttoi pas çdo hapi të aplikimeve dhe siguroi që të isha gjithmonë drejt rrugës së duhur për t'u pranuar. Punuam me letra rekomandimi, letra motivimi, ese personale, CV, certifikata dhe aktivitete në të cilat mund të bëhesha pjesë për të pasuruar CV-në time. Këshilltarja jonë e shkollës, znj. Sonila ka qenë gjithnjë e disponueshme për secilin prej nesh, por akoma më e rëndësishme është se ajo na ka motivuar dhe frymëzuar që të bëjmë zgjedhjet e duhura në lidhje me studimet tona të ardhshme, në rastin tim në lidhje me arkitekturën. Në fund, me ndihmën e saj, arrita të pranohesha në disa universitete duke përfshirë UC Berkeley, Michigan University, Northeastern, Worcester Polytechnic Institute etj. Kam pasur mundësi të zgjedh mes disa prej universiteteve më të mira në botë dhe tani jam duke pritur që semestri i vjeshtës të fillojë.

MATURANTËT E SHKOLLËS SË MESME “TURGUT OZAL” TIRANË TË PRANUAR NË UNIVERSITETET NDËRKOMBËTARE 2018-2019



EMILIO PASHAJ
Concord University
West Virginia, USA



TEDI TOTOJANI
Colgate University
New York, USA



PETRAQ XHEPA
Wentworth Institute of
Technology, Massachusetts, USA



HELIO RAMOLLARI
Whitworth University
Washington, USA



XHULIANO ÇOLLAKU
Hofstra University
New York, USA



PETRI GJONI
Jacobs University
Germany



DEA BARDHOSHI
University of California
Berkeley, USA



SARA LAVDARI
Pace University
New York, USA



INES BICI
University of California
Berkeley, USA



ARKLEJDA OSHAFI
AUBG
Bulgaria



JONA DULAJ
IMC University
Austria



BLEON BELBA
University of East London
England



ERI DURBAKU
Richmond University
England



RUBEN VATHI
IUBH
Germany



DEAN GANI
Erasmus University
Netherlands



Iljana Çekrezi
Tilburg University
Netherlands





JORIDA NUREDINI
IUBH
Germany



ARLIND MAZE
Tilburg University
Netherlands



KEJSI BOCI
HAN University
Netherlands



PAMELA TAHIRI
Hague University
Netherlands



FRENKLI MYTEVELIU
Memorial University of
Newfoundland, Canada



KEJSI KORBI
Bergen Community College
New Jersey, USA



IGLI ISUFAJ
Columbus State Community
College, Ohio, USA



Adea Nuri
TUM
Germany



LEDIA ÇUPI
UIBS
Italy



KLAUDIO LESKAJ
Erasmus University
Netherlands



ILIA MARKO
Jacobs University
Germany



JOZEF GURAKUQI
Bocconi University
Italy



ORKIDEA KRAJA
University of Illinois
Chicago, USA



ESTER SAKO
Cologne Business School
Köln, Germany



**GRADUATES OF "TURGUT
OZAL" HIGH SCHOOL
TIRANA ACCEPTED IN
INTERNATIONAL
UNIVERSITIES 2018-2019**



EPOKA
UNIVERSITY